

**STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“ABA BLUE BORGO” SH.P.K.**

Data 15.01.2024



## TABELA E LËNDËS

<b>KREU I. TË PËRGJITHSHME .....</b>	<b>3</b>
<b>NENI 1.01 PËRKUFIZIME.....</b>	<b>3</b>
<b>NENI 1.02 EMRI I SHOQËRISË DHE ORTAKËT.....</b>	<b>3</b>
<b>NENI 1.03 OBJEKTI I VEPRIMTARISË .....</b>	<b>3</b>
<b>NENI 1.04 KOHËZGJATJA .....</b>	<b>4</b>
<b>NENI 1.05 SELIA .....</b>	<b>4</b>
<b>NENI 1.06 VULA .....</b>	<b>4</b>
<b>NENI 1.07 DEGËT, ZYRAT E PËRFAQËSIMIT DHE SHOQËRITË E KONTROLLUARA.....</b>	<b>4</b>
<b>KREU II. KAPITALI I REGJISTRUAR.....</b>	<b>4</b>
<b>NENI 2.01 VLERA DHE PAGESAT E KAPITALIT TË REGJISTRUAR .....</b>	<b>4</b>
<b>NENI 2.02 CERTIFIKATAT E KUOTAVE .....</b>	<b>5</b>
<b>NENI 2.03 KALIMI ME KONTRATË I KUOTAVE.....</b>	<b>5</b>
<b>NENI 2.04 KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI OSE SI PASOJË E FALIMENTIMIT.....</b>	<b>5</b>
<b>NENI 2.05 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË REGJISTRUAR .....</b>	<b>6</b>
<b>NENI 2.06 ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË REGJISTRUAR.....</b>	<b>6</b>
<b>KREU III. ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME .....</b>	<b>6</b>
<b>NENI 3.01 THIRRJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME .....</b>	<b>6</b>
<b>NENI 3.02 MBLEDHJET E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME .....</b>	<b>7</b>
<b>NENI 3.03 VOTAT E ORTAKËVE .....</b>	<b>8</b>
<b>NENI 3.04 VOTIMI ME PROKURË .....</b>	<b>8</b>
<b>NENI 3.05 HETIMET E POSAÇME .....</b>	<b>9</b>
<b>NENI 3.06 EKSPERTI KONTABËL .....</b>	<b>9</b>
<b>KREU IV. ADMINISTRATORI .....</b>	<b>9</b>
<b>NENI 4.01 EMËRIMI I ADMINISTRATORIT .....</b>	<b>9</b>
<b>NENI 4.02 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT .....</b>	<b>9</b>
<b>NENI 4.03 SHPËRBLIMI DHE PËRFITIMET E TJERA.....</b>	<b>9</b>
<b>KREU V. DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN E REGJISTRUAR .....</b>	<b>10</b>
<b>NENI 5.01 DIVIDENDËT .....</b>	<b>10</b>
<b>NENI 5.02 KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN E REGJISTRUAR .....</b>	<b>10</b>
<b>KREU VI. PRISHJA DHE NJOFTIMET .....</b>	<b>10</b>
<b>NENI 6.01 PRISHJA DHE LIKUIDIMI.....</b>	<b>10</b>
<b>NENI 6.02 NJOFTIMET .....</b>	<b>10</b>



## KREU I. TË PËRGJITHSHME

### Neni 1.01 Përkufizime

Në këtë Statut:

“**Ditë të Plota**” në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.

“**Ligji**” është ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, i ndryshuar.

“**Ortaku**” ose “**Ortakët**” ka kuptimin që i jepet te Neni 1.02(b) (*Emri i Shoqërisë dhe Ortakët*) i këtij Statuti.

“**Qendra Kombëtare e Biznesit**” ose “**QKB**” ka kuptimin e institucionit sipas ligjit nr.9723 datë 3.5.2007 “*Për regjistrimin e biznesit*” i ndryshuar, si dhe çdo institucion tjetër që në të ardhmen mund të marrë kompetencat e këtij institucioni.

“**Statuti**” është Statuti i Shoqërisë.

“**Shoqëria**” ka kuptimin që i jepet te Neni 1.02(a) (*Emri i Shoqërisë dhe Ortaku*).

### Neni 1.02 Emri i Shoqërisë dhe Ortakët

- (a) Emri i shoqërisë është “**ABA BLUE BORGO**” sh.p.k (në vijim “**Shoqëria**”).
- (b) Ortakët e Shoqërisë janë (ku në vijim do t’u referohet së bashku si “**Ortakët**” dhe veç e veç si “**Ortaku**”):
  - (i) Shoqëria “**ABA HOSPITALITY**” SHPK, një shoqëri e organizuar dhe regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, datë 20.12.2023, me Nr. NIPT: M32420016C, me seli ne Rr. “Papa Gjon Pali i II-te”, Ndërtesa nr. 12, ABA Business Center, kati i 7-te teknik, Njesia Administrative nr.2, Tirane, Shqipëri, Nr. Pasurie 7/52-N9 e llojit “Njësi”, regjistruar ne ASHK, Zona Kadastrale 8160, vol. 36, fq.212 me përfaqësues ligjor Z. Andri Kasneci, me numër personal identiteti I30606204L, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

### Neni 1.03 Objekti i Veprimtarisë

- (a) Shoqëria do të kryejë në territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj aktivitetin e meposhtem ne fushen e turizmit:
  - (i) Zhvillimi dhe /ose operimi per vete dhe per te trete, i burimeve te ndryshme turistike, perfshire ne menyre jo-shterruese zhvillimi dhe/ose operimi i sipërmarrjeje turistike ne fushen e strukturave akomoduese, si hotel, kompleks turistik dhe struktura të tjera akomoduese, i infrastrukturave mbeshtetese dhe sherbimeve argetuese e mikpritese; Veprimtari te tjera per promovimin e turizmit.

- (ii) Themelimi dhe krijimi i shoqërive dhe sipërmarrjeve shqiptare dhe të huaja, si dhe pjesëmarrja në to, administrimi dhe drejtimi i shoqërive tregtare dhe sipërmarrjeve vendase apo të huaja, të cilat ushtrojnë aktivitete në fushën e turizmit; Marrja pjesë në shoqëri e bashkime shoqërisht të themeluara apo në themelim të sipër, në çdo formë të parashikuar nga Ligji që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin, apo pjesëmarrje të tjera, që i shërbejnë rritjes së mëtejshme dhe arritjes së qëllimeve të Shoqërisë;
- (iii) Në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë (A) çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme apo ato të paluajtshme, si dhe të kryejë çdo aktivitet tregtar, financiar, përfshirë titujt, të vendosë pengje dhe barrë hipotekare mbi kuota/aksione të shoqërive të krijuara ose ku ajo është pjesëmarrëse; aktivitete këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë, dhe të shoqërive e sipërmarrjeve të themeluara/krijuara, apo në të cilat Shoqëria fiton pjesëmarrje si dhe (B) çdo veprimtari tjetër të lejuar nga ligji.
- (b) Shoqëria do të kryejë çdo lloj aktiviteti dhe çdo lloj operacioni ekonomik, juridik e financiar si dhe çdo operacion biznesi, që lidhet direkt apo indirekt me objektin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe për të favorizuar atë, Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore të duhura. Ajo zbaton standardet më të larta të etikës.

#### **Neni 1.04 Kohëzgjatja**

Shoqëria do të operojë pa kohëzgjatje të përcaktuar.

#### **Neni 1.05 Selia**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Ndërtesa nr. 12 “ABA Business Center”, kati I 7-te teknik, Njesia Administrative nr.2, Tiranë, Shqipëri.

Të dhënat kadastrale të pasurisë së paluajtshme ku ndodhet Selia janë: *Nr. Pasurie 7/52-N9 e llojit “Njësi”, regjistruar në ASHK, Zona Kadastrale 8160, vol. 36, fq.212.*

#### **Neni 1.06 Vula**

Shoqëria ka vulën e saj mbi të cilën ka të shkruar emërtimin e saj tregtar.

#### **Neni 1.07 Degët, Zyrat e Përfaqësimit dhe Shoqëritë e Kontrolluara**

Shoqëria mund të hapë degë, zyra përfaqësimi dhe shoqëri të kontrolluara brenda Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

## **KREU II. KAPITALI I REGJISTRUAR**

#### **Neni 2.01 Vlera dhe Pagesat e Kapitalit të Regjistruar**

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mije) lekë. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtem:

- (i) Ortaku: Shoqëria “ABA HOSPITALITY” sh.p.k.  
Vlera e kontributit: 100,000 (njëqind mijë) Lekë

Kuota e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë: 100%  
Numri i kuotave: 1 (një)

### **Neni 2.02 Certifikatat e Kuotave**

Secili Ortak ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i certifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave, në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit. Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në certifikatën e kuotës. Certifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

### **Neni 2.03 Kalimi me Kontratë i Kuotave**

- (a) Kur një Ortak dëshiron të shesë kuotën e tij plotësisht apo pjesërisht, Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes. Kuota duhet t'i ofrohet së pari Ortakëve të tjerë me të njëjtat kushte që do t'i ofrohej të tretëve.
- (b) Ortakët e tjerë mund të shfaqin interes për blerjen e kuotës jo më vonë se [dy javë] pas marrjes së propozimit nga Ortaku që dëshiron të shesë kuotën. Nëse Ortakët nuk shprehen brenda këtij afati, heshtja do të konsiderohet si refuzim dhe Ortaku do të konsiderohet se e ka respektuar të drejtën e parablerjes.
- (c) Pas respektimit të së drejtës së parablerjes, Ortaku që dëshiron të shesë kuotën mund të negociojë me të tretët për të shitur kuotën me kushtet që iu parashtruan Ortakëve të tjerë kur u përmbush e drejta e parablerjes. Nëse negociatat mes Ortakut dhe personit të interesuar për të blerë kuotën ndryshojnë kushtet e shitjes, e drejta e parablerjes rinovohet.
- (d) Është e ndaluar shitja apo ndonjë mënyrë tjetër kalimi pronësie i kuotës te të tretët, kur Asambleja e Përgjithshme nuk ka dhënë vendim me shumicë prej [75]% të kapitalit të Shoqërisë për pranimin paraprak të kalimit të tretit. Kur një prej Ortakëve të tjerë dëshiron të blejë kuotën, për këtë shitje nuk është i nevojshëm të merret miratimi i Asamblesë së Përgjithshme.
- (e) Nëse Asambleja e Përgjithshme refuzon kalimin e kuotës, administratorët do të njoftojnë për mospranimin Ortakun që do të shesë kuotën, brenda 1 (një) muaji nga data në të cilën është paraqitur në Shoqëri kërkesa për miratimin e kalimit të kuotës.

### **Neni 2.04 Kalimi i Kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit**

- (a) Nëse një Ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga Shoqëria si gëzues të të drejtave mbi kuotën e tij. Pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e Ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.
- (b) Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një Ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej Shoqërisë si përfitues të kuotës.

- (c) Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një Ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në QKB.

#### **Neni 2.05 Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar**

- (a) Zmadhimi i kapitalit të regjistruar mund të bëhet nëpërmjet kontributeve në para, kontributeve në natyrë, ose nëpërmjet përfshirjes së rezervave apo fitimit në kapitalin e regjistruar.
- (b) Zmadhimi i kapitalit të regjistruar mund të bëhet sipas formave të parashikuara më poshtë:
- (i) duke rritur proporcionalisht vlerën e kuotave të gjithë Ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës, pasi gjithë Ortakët kanë derdhur apo premtuar për të derdhur kontributet përkatëse;
  - (ii) duke rritur proporcionalisht vlerën e kuotave të disa Ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës, pasi ata Ortakë kanë derdhur apo premtuar për të derdhur kontributet përkatëse;
  - (iii) duke pranuar kontribute nga një ortak i ri në Shoqëri, pasi është marrë vendimi nga Asambleja e Përgjithshme.
- (c) Për zmadhimin e kapitalit sipas parashikimeve të:
- (i) Neni 2.05(b)(i) më lart, Asambleja e Përgjithshme merr vendim me vota unanime;
  - (ii) Neni 2.05(b)(ii) dhe (iii) më lart, Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shumicë sipas nenit 87.1 të Ligjit.

#### **Neni 2.06 Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar**

- (a) Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.
- (b) Zvogëlimi i kapitalit të regjistruar mund të bëhet sipas formave të parashikuara më poshtë:
- (i) duke ulur proporcionalisht vlerën e kuotave të gjithë Ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës;
  - (ii) me anulimin e ndonjë apo disa kuotave, sipas përcaktimeve të Ligjit dhe Statutit.

### **KREU III. ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 3.01 Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

- (a) Administratori thërret Asamblenë e Përgjithshme dhe, me kërkesën e Ortakëve sipas nenit 84 të Ligjit, do të procedojë me thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme.

- (b) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (e-mail) drejtuar çdo Ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga gjithë Ortakët unanimitisht. Secilit Ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe numri PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin elektronik në mbledhje.
- (c) Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme janë të pavlefshme edhe në rast moskryerje të paqëllimshme të njoftimit apo mosmarrjes së njoftimit të mbledhjes nga personat të cilët kanë të drejtë të marrin këtë njoftim, me përjashtim të rastit kur Shoqëria provon se personi i ka dhënë Shoqërisë një adresë të pasaktë.

### **Neni 3.02 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme**

- (a) Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga Neni 86 i Ligjit. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call), audio ose audio-video, në përputhje me nenin 88 të Ligjit. Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
- (b) Administratori kryeson mbledhjen dhe cakton një person për të mbajtur procesverbalin e saj.
- (c) Nëse administratori nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse ai nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, Ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
- (d) Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.
- (e) Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga
  - (i) Kryetari; ose
  - (ii) një Ortak ose Ortakët që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themeltar të Shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i Ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë Ortaku.
- (f) Me përjashtim të kundërshtimit të një Ortaku, deklarimi i Kryetarit se vendimi është marrë në mënyrë unanime, ose me një shumicë të caktuar, nuk është miratuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e



mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.

- (g) Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

### Neni 3.03 Votat e Ortakëve

- (a) Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep Ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose Ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote me peshë në votim në përputhje me vlerën nominale të kuotës së tij. Në përputhje me nenin 88.1 të Ligjit, asnjë Ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.
- (b) Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do t'i komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

### Neni 3.04 Votimi me Prokurë

- (a) Përfaqësuesi do të emërohet nga Ortaku sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga administratori):

*“Unë/Ne i/të nënshkruari/t, \_\_\_\_\_ në cilësinë e Ortakut/Ortakëve të Shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më \_\_\_\_\_ ose në pamundësi të tij, \_\_\_\_\_, në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë e cila do të mbahet më \_\_\_\_\_ dhe në çdo mbledhje të shtyrë.  
Nënshkruar më \_\_\_\_\_”*

- (b) Në rastet kur dëshirohet t'u jepet Ortakëve mundësia për të udhëzuar përfaqësuesin për mënyrën e veprimit, caktimi i përfaqësuesit bëhet sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga Administratori):

*Unë/Ne i/të nënshkruari/t, \_\_\_\_\_, në cilësinë e Ortakut/Ortakëve të Shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më \_\_\_\_\_, ose në pamundësi të tij, \_\_\_\_\_, në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë e cila do të mbahet më \_\_\_\_\_, dhe në çdo mbledhje të shtyrë.*

*Kjo formë do të përdoret për vendimet e përmendura më poshtë:*

*Vendimi Nr. 1 \*pro \*kundër Vendimi Nr. 2 \*pro \*kundër.*

*Përveç udhëzimeve të tjera, përfaqësuesi mund të votojë ose abstenojë, siç e quan të arsyeshme. Nënshkruar më \_\_\_\_\_”.*

- (c) Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga administratori depozitohet në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga Shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.



### **Neni 3.05 Hetimet e Posaçme**

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas nenit 91 të Ligjit paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklarate noteriale në selinë e Shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

### **Neni 3.06 Eksperti Kontabël**

Asambleja e Përgjithshme emëron me shumicë të thjeshtë ekspertin kontabël të Shoqërisë.

## **KREU IV. ADMINISTRATORI**

### **Neni 4.01 Emërimi i Administratorit**

- (a) Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si administratorë të Shoqërisë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si administrator.
- (b) Kufizimet në lidhje me emërimin e administratorëve parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit.
- (c) Zj. Sonila Imeraj, shetase Shqiptare, lindur me 25.05.1980, ne Orikum, Shqiperi, banuese ne Tirane, identifikuar me Leternjoftim ID me nr. personal I05525066S, caktohet administrator i Shoqërisë me një mandat që fillon në datën e themelimit të Shoqërisë, dhe përfundon me kalimin e 5 (pesë) viteve nga ajo datë.

### **Neni 4.02 Kompetencat e Administratorit**

- (a) Politikat tregtare të Shoqërisë do të administrohen nga administratorët të cilët mund të ushtrojnë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 81 të Ligjit si dhe kompetencat që i jepen administratorëve sipas nenit 95 të Ligjit. Ndryshimet e Statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme nuk do të shfuqizojnë aktet e mëparshme të administratorit, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.
- (b) Secili prej administratorëve mund të marrë vendime individualisht, pa u kufizuar nga miratimi i administratorit tjetër.
- (c) Administratori mund t'ua delegojë kompetencat e tij çdo komiteti i cili përbëhet nga një ose më shumë administratorë. Çdo delegim kompetencash kryhet në përputhje me kushtet që vendos Asambleja e Përgjithshme dhe mund të revokohet ose ndryshohet. Administratori nuk mund të delegojë detyrimet e tij ligjore.

### **Neni 4.03 Shpërblimi dhe Përfitimet e Tjera**

- (a) Administratori shpërblehet në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e nenit 97 të Ligjit.



- (b) Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në Shoqëri, Shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë Shoqëri të kontrolluara ose për Shoqëri paraardhëse të Shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguajë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla.

## **KREU V. DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN E REGJISTRUAR**

### **Neni 5.01 Dividendët**

- (a) Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, Shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të Ortakëve.
- (b) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhet në përputhje me shumën e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhet në përpjesëtim të drejtë me shumën e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- (c) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj Shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

### **Neni 5.02 Kalimi i Fitimeve në Kapitalin e Regjistruar**

Administratori, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shumën e tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të Shoqërisë.

## **KREU VI. PRISHJA DHE NJOFTIMET**

### **Neni 6.01 Prishja dhe Likuidimi**

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të Ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis Ortakëve të Shoqërisë.

### **Neni 6.02 Njoftimet**

- (a) Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

- (b) Shoqëria mund të njoftojë një Ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të Ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar Shoqërisë nga Ortaku. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.
- (c) Ortakët do të njoftohen në adresat e tyre të deklaruar te Administratori i Shoqërisë.

**Ortaku i Vetëm:**

**Shoqëria “ABA HOSPITALITY” sh.p.k.**  
Administrator  
**Z. Andri Kasneci**

*Andri Kasneci*



Faint, illegible text at the top of the page, possibly a header or introductory paragraph.

Handwritten text in the middle of the page, possibly a title or a list of items.

